



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:187185

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396898

KF.nr.387/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Segment Kosova” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810871328 dhe seli në magjistralen Prishtinë Gjilan km. I-rë, Veternik, Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti – klasifikim tarifor, vlerë kontesti – 6,806.46 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur me 13.02.2024, në prani të përfaqësuesit të autorizuarit të palës paditëse avokat K.P. dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur M.K., me morri këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Segment Kosova” Sh.P.K, si e bazuar.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/301-19 të datës 13.07.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit, Segment Kosova” Sh.P.K, t’ia kthejë mjetet e paguar në emër të taksës doganore në vlerë prej 6,806.46 € (gjashtëmijë e tetëqind e gjashtë euro e dyzet e gjashtë cent), me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë me 20.08.2021 e deri në kthimin e plotë, në afat prej 15 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësi “Segment Kosova” Sh.P.K, me seli në Prishtinë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 24.08.2021, ka iniciuar kontest tregtar-administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/301-19 të datës 13.07.2021, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e.3.2.2/507/2018 A1.H. i datës 02.03. paditësit “Segment Kosova” Sh.P.K, të anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/301-19 të datës 13.07.2021 i Doganës së Kosovës me të cilin e paditura ka ndryshuar kodet doganore të deklaruara nga Paditësi dhe e ka obliguar paditësin të paguaj obligimin doganor shtesë në vlerë totale prej 6806,46 euro i përbërë nga taksa doganore prej 10% në shumën prej 5,768.12 euro dhe TVSH prej 18 % në shumën prej 1,038.46 euro si dhe të detyrohet e paditura t'ia kompensoj të gjitha shpenzimet procedurale të krijuara në këtë kontest gjyqësor. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditëses ka deklaruar se Vendimi i kontestuar i të paditurës është marrë pas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me A.nr. 301/19 të dt. 20.05.2021 me të cilën lënda i ishte kthyer të paditurës për rishqyrtim dhe rivendosje sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykimin e gjykatës. Në procedurën e rivendosjes e paditura ka nxjerrë vendimin e njëjtë sikurse vendimi paraprak i cili ishte anuluar nga gjykata si dhe kishte arsyetuar ngjashëm sikurse vendimi i anuluar nga gjykata, konkretisht aktgjykimi i gjykatës kishte kërkuar që të plotësohej mendimi tarifor i sektorit të tarifës duke marrë parasysh informatën tarifor e detyruese me nr. XK-2019-04.1.2-05 e dt.. 30.07.2019 e lëshuar nga vet e paditura përmes të cilës pajisjet e paraqitura nga paditësi për zhdoganim ishin klasifikuar me kodin tarifor 8431 4300 00 si dhe të marrë parasysh njoftimin e klasifikimit detyrues me nr. Setv-2018-14358 të Bashkimi Evropian me të cilin mallrat përkatësisht pajisjet e paraqitura për zhdoganim nga paditësi ishin klasifikuar me kodin doganor 8431 430000. Tutje ka shtuar se në kundërshtim me udhëzimet e gjykatës dhe në kundërshtim me vet vendimin e të paditurës përkatësisht me informatën tarifore detyruese të cituar më lart e paditura qëndroi pranë vendimit të saj të mëparshëm duke arsyetuar se se sektori për klasifikimin e mallrave është sektor profesional i cili mendimet dhe konstatimet e veta i mbështet në Nomenklaturën e mallrave në Tarik dhe duke dhënë arsye tjera të përgjithshme lidhur me klasifikimin e mallrave sipas aktvendimit të kontestuar. Për këtë arsye duke qenë se e paditura nuk i ka respektuar udhëzimet e gjykatës dhe për arsye të tjera të cekura në padi konsideron se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, vendimi i kontestuar duhet të anulohet dhe detyrimet doganore të ngarkuara pa bazë faktike dhe juridike në vlerë prej 6,806.46 euro duhet ti kthehen paditësit pas aprovimit të kërkesë padisë. Njoftimi i klasifikimi detyrues BTI SEBTIV-2018-14358 është lëshuar në emër të

eksportuesit në këtë rast Epriok Drilling Tools AB me seli në Suedi i cili ia ka transmetuar këtë dokument paditësit për qëllime të njoftimit të Doganës së Kosovës me këtë njoftim të klasifikimit detyruës sipas të cilit nga vendi i origjinës së mallrave produktet e paraqitura për import në Kosovë janë klasifikuar me Kodin Doganor sikur është paraqitur nga paditësi.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 05.10.2021 e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës ka deklaruar se vendimi kontestues është tërësisht i ligjshëm dhe konform KDA dhe Tarikut dhe i mbështetur edhe me sqarime profesionale nga sektori përkatës. Pretendimi i paditësit se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk ekziston dhe nuk mund të mbështet me asnjë provë të vetme. Në ri procedurë dogana ka sqaruar vërejtjet e dhëna nga gjykata në lidhje me mendimin tarifor për të cilin sot kemi thirrur dëshmitarin në cilësi të udhëheqësit të sektorit të Tarifës. Sa i përket BTI nr. 2018-14358 kjo BTI nuk është lëshuar për paditësin andaj edhe nuk besoj që mund të përdoret si provë në këtë rast. E njëjta është kundërshtuar gjatë proceseve gjyqësore.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurë provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 12.02.2024, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 03.1.1-2018-397/1 i dt. 10.10.2018 së bashku me aneks dhe listë, Aktvendimi 01.3.2.2/680 i dt. 26.12.2018, Aktvendimi 01.3.2.2/301-19 i dt. 13.07.2021, Aktgjykimi A.nr. 301/19 i dt. 20.05.2021, Sqarim shtesë nga ST i dt. 13.07.2021, Mendim për klasifikim tarifor 124, 125, 126, 127, 128 dhe 129, Përgjigje e dt. 30.07.2019 dhe aneksi 2, DUD RR-11352 dt. 19.05.2017, Faturë 11052017, Deklarata eksportuese SE 092714, DUD nr. 3467 dt. 17.03.2018, Faturë nr. 1118000212/HR1/01, BTI SEBTITV-2018-14358 dt. 07.02.2019, Vendimi i njoftimit për klasifikim të detyruar dt.06.02.2019 me nr. XK-2019-04.1.2-05, Katallog i mallit lëndor, Përgjigje në padi e dt.23.08.2023.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi dhe seancë, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar-administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, shkresat e lëndës, aktvendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se zyrtarë nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese duke vepruar sipas detyrës zyrtare kanë ushtruar kontroll dokumentare për importet e paditësit nën dyshimin se nuk është tarifuar drejtë malli i importuar “pjesë për makineri shpuese” me numër tarifor 84314300, sipas deklaratave doganore të cekura në Aneksin 1, duke e liruar mallin nga taksat doganore 10%, 6% dhe 4%, (varësisht siç është parapa me MSA), ndërsa duhet të jenë kodet tarifore 8207509000, 8207199000, 8207130000 dhe të paguaj taksa doganore në vlerë totale prej 6,806.46 euro. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, me datë 09.11.2018, ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 26.12.2018, ka nxjerr Aktvendimin nr. 01.3.2.2/680, si akt administrativ përfundimtar i marr në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës, 31.01.2019, ka inicuar konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate. Duke vepruar sipas kësaj padie Gjykata ka marr Aktgjykimin A.nr.301/19 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë dhe ka kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura. E paditura në rivendosje ka nxjerr aktvendimin e kontestuar nr.01.3.2.2/301-19 të datës 13.07.2021, ndaj të cilit paditës ka parashtruar padinë lëndore.

Gjykata sipas aktgjykimit të lartcekur ka kërkuar nga e paditura që në riprocedurë të kërkoj edhe njëherë nga Sektori i Tarifës të plotësojë mendimin tarifor, lidhur me mallin lëndor të deklaruar në DUD-at kontestues sipas përshkrimit të mallit në dokumentet përcjellës, ashtu që mendimin e vet profesional ta mbështet në shënimet e TARIK-ut, deklaratën eksportuese, sqarimeve plotësuese nga pala, eksportuesi dhe/apo prodhuesi për llojin dhe karakteristikat e mallit lëndor, si dhe të verifikoj dokumentacionin përcjellës dhe të shqyrtoj pretendimet e paditësit lidhur me Informatën tarifore detyruese nga Komisioni Evropian, BTI nr. SEBTITV-2018-14358 datë 06.02.2019, por edhe me BTI-në e lëshuar nga vet Dogana e Kosovës dhe atë nr. XK-2019-04.1.2-05 datë 30.07.2019. Gjithashtu ka urdhëruar të paditurën të përcaktoj saktë dhe të sqaroj në detaje duke vënë në pah elementet dalluese të mallit lëndor, në raport me kodet tarifore 84314300 siç është deklaruar dhe kodeve tarifore siç vlerëson e paditura, dhe duke e lidhur edhe me elementet përcaktuese të mallit lëndor sipas DUD-ve kontestues, që kanë qenë vendimtare në vendosje nga e paditura.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, gjykata ka konstatuar faktin se e paditura duke vepruar në ri procedurë sipas aktgjykimit të kësaj gjykate A.nr.301/19 të datës 20.05.2021, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e paditësit, ishte anuluar vendimi nr.01.3.2.2/680 i datës 26.12.2018 dhe lënda ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi-ka konfirmuar vendimin e nr.03.1.1-2018-397/1 të datës 10.10.2018, të lëshuar nga Sektori i Kontrollës pas Importuese.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues, gjykata konstaton se arsyetimi i të paditurës nuk është i mjaftueshëm konform të kërkuarave, ashtu që e njëjta nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës. Bazuar në aktgjykimin e gjykatës sektori i tarifës ka qenë i obliguar të plotësoj mendimin tarifor ndër të tjera duke shqyrtuar informatën tatimore detyruese nga Komisioni Evropian përkatësisht BTI nr. SEBTITV-2018-14358 por edhe BTI të lëshuar nga vet Dogana e Kosovës XK-2019-04.1.2-05.

E paditura në vendimin e kontestuar nuk ka vepruar konform këtij obligimi por në mënyrë të përgjithësuar ka arsyetuar se i sqaron Gjykatës se Sektori për Klasifikim të Mallrave është Sektor profesional i cili mendimet, konstatimet e veta i mbështet në nomenklaturën e mallrave në TARIK përcaktohet sipas rregullave të përgjithshme për interpretim të nomenklaturës së mallrave, siç është publikuar në nomenklaturën e kombinuar të Unionit Evropian, shënimet shtesë të TARIK-ut dhe Direktivës për interpretim të nomenklaturës së mallrave në TARIK, që përbëhet nga shënimet sqaruese të sistemit të harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganave dhe të shënimeve sqaruese për Nomenklaturën e Kombinuar të Unionit Evropian. Bazuar në rregullat gjenerale 1 deri 6 mbi klasifikimin e mallrave për qëllime ligjore klasifikimi përcaktohet në përputhje me kushtet e krerëve dhe shënimeve të ndonjë seksioni apo kapitulli përkatës me kusht që të tillë krerë ose shënime nuk specifikojnë ndryshe.

Po ashtu, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, i pyetur nga përfaqësuesi i paditësit a i kanë shqyrtuar këto dy dokumente me rastin e plotësimit të mendimit tarifor dëshmitari sqaron se kjo informatë detyruese e BE-së nuk është obligative për ne, obligative për ne janë sqarimet

të kapitullit të kreut tarifor në rastet në kontest. Këto janë obligative me ligj jo informatat e BE-së.

Se cilat dokumente duhet t'i bashkëngjiten deklarates doganore është rregulluara me neni 123 të udhëzimit administrativ 9/2010, ku në paragrafin 1 pika c) është përcaktuar se ;  
c) *Dokumentet e kërkuara për aplikimin e aranzhimeve preferenciale tarifore dhe masat e tjera që dalin nga rregullat ligjore të zbatueshme për mallrat e deklaruar;*” .Ndërsa në nenin 17 të KDA-së është përcaktuar “*Çdo person mund të kërkojë nga Dogana informata në lidhje me aplikimin e legjislacionit doganor. Një kërkesë e tillë mund të refuzohet kur nuk ka të bëjë me një import ose eksport të mallrave. 2. Informacioni do t'i sigurohet ushtruesit të kërkesës falas. Sidoqoftë, nëse linden shpenzime të veçanta për Doganën, posaçërisht si rezultat i analizave ose si rezultat i raporteve të ekspertëve për mallin ose kthimin e mallrave të kërkuar, atij mund t'i ngarkohet shuma relevante e shpenzimeve.*”, ndërsa neni 18 par 1 i të njëjtit kod përcakton se “*Dogana do të lëshojë informacion të detyrueshëm tarifor ose informacion të detyrueshëm të origjinës në bazë të kërkesës me shkrim, duke vepruar në përputhje me dispozitat për zbatimin e këtij Kodi.*”

Tutje, gjykata vlerëson se e paditura nuk ka vepruar në kuptim të udhëzimeve lidhur me dallimin në klasifikimin e mallrave, e po ashtu edhe gjatë seancës gjyqësore ka kundërshtuar pyetjen e përfaqësuesit të paditësit lidhur me këtë çështje duke sqaruar se vet klasifikimi është dallim i mallrave. Ndërsa lidhur me pyetjen se sa i përket BTI XK-2019-04.1.2-05 a lidhet me llojin dhe importet e këtij malli, Dëshmitari ka sqaruar se mendimet e lëshuara nga ai personalisht për importuesin Segment Kosova janë të vitit 2018 kurse kjo informatë tarifore detyruese është e vitit 2019 dhe bazuar në KDA neni 18 ceket se një informatë tarifore detyruese e lëshuar nga Dogana e Kosovës është detyruese për subjektin kërkues të kësaj informate tarifore detyruese dhe për Doganën e Kosovës nga momenti i njoftimit të subjektit të parashtruesit të kërkesës nga viti 2019 e tutje, me vlefshmëri prej 6 vite, kurse rastet që janë në kontest datojnë nga viti 2018, andaj kjo informatë detyruese nuk mund të merret për bazë.

Nga provat e administruara gjykata konstaton se paditësi gjatë deklarimit të mallit lëndor ka bashkëngjitur Informacioni Tarifor Detyrues siç është përcaktuar në nenet 17 dhe 18 të KDA-së. Pretendimet e të paditurës se BTI është e vlefshme nga viti 2019 e tutje ndërsa

kontesti daton nga 2018, gjykata e vlerësoi si të pabazuar meqenëse malli i importuar është i njëjtë dhe se kjo informatë nuk është e kundërshtuar nga paditësi, që të mund të konsiderohet detyruese siç pretendon e paditura. Një pretendim i tillë do të mund të merrej për bazë në rast se e paditësi ka kundërshtuar një informatë detyruese, por jo edhe në rastin konkret.

Prandaj nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata pretendimet e paditësit i gjeti si tërësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform kodit doganor të deklaruar 84303900.

Rrjedhimisht, gjykata konform dispozitave nga neni t 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'ia pranoj deklarin e kodit tarifor 84303900 për mallin lëndor sipas DUD-it R-11352 të datës 19.05.2017 dhe DUD-it R-3467 të datës 17.03.2018 dhe t'ia kthejë shumën e paguar në emër të taksës doganore 10%, prej 5,768.12 euro dhe TVSH-së prej 1,038.46 euro, e të gjitha së bashku në shumën prej 6,806.46 € me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë me datë 24.08.2021, e deri në pagesën definitive.

Gjykata i ka vlerësuar deklarinimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Për kamatën Gjykata ka vendos duke u mbështetur në dispozitat e KDAK-së, Kodi Nr. 03/L-109, neni 292, pika b), *“Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: ((b) Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme”*, dhe në nenet 378 dhe 382 të LMD-së, ndërsa si moment të fillimit të kamatës mori datën e parashtrimit të padisë në gjykatë.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, gjykata në konform nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.387/22, datë 29.02.2024

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.